



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	15.03.2018	Dep. <u>DPK</u> Nr. Prot. <u>03-03/841/18</u> Br. Prot. <u>03-03/841/18</u> Prot. No. <u>03-03/841/18</u> Nr. lfaq. <u>03</u> Datum <u>15-03-2018</u> Broj stranica <u>03</u> Date <u>15-03-2018</u> Nr. pages <u>03</u>
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-781/18 PRISHTINË	
PËR/ZA/TO:	z. Arben Koci Menaxher i zyrë së Prokurimit Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	
CC:	z. Bahri Nuredini Drejtor e Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Furnizim me IP kamera te jashtme dhe te brendshme” me nr. të prokurimit 254/18/1265/136, nr. të brendshëm ASHNA/18/016/136.	

E nderuari z. Koci

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **“Furnizim me IP kamera te jashtme dhe te brendshme”** me nr. të prokurimit 254/18/1265/136, nr. të brendshëm ASHNA/18/016/136, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **“Furnizim me IP kamera te jashtme dhe te brendshme”** me nr. të prokurimit 254/18/1265/136, nr. të brendshëm ASHNA/18/016/136, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 12 mars 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-781/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me IP kamera te jashtme dhe te brendshme”** me nr. të prokurimit 254/18/1265/136, nr. të brendshëm ASHNA/18/016/136, nr. të brendshëm 611/18/018/521, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Agjencia e Shërbimeve te Navigacionit Ajror.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë kuotim i çmimit, kontratë publike, llojit furnizim, me vlerë të vogël. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që në njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: *“OE duhet të dëshmoj se ka kryer ose kryen punë të ngjashme ose ekuivalente”*, ndërsa tek dëshmia e kërkuara dokumentare është kërkuar: *“Të paktën një referencë të lëshuar nga ndonjë autoriteti kontraktues në tri vitet e fundit që dëshmon se OE ka kryer ose kryen punë të ngjashme ose ekuivalente”*, kërkesë kjo për të cilën Agjencia gjithashtu konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Bazuar në legjislacioni në fuqi konkretisht nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenin 26.8 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se një autoritet kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkoj si dëshmi kontrata dhe referenca me të cilat do ta vërtetonte kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë të tillë, për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, duhet të ceket ***referenca apo certifikata të autoriteteve publike dhe personave privat***, e jo siç ka vepruar në rastin konkret autoriteti kontraktues duke cekur vetëm referenca të ndonjë autoriteti kontraktues.

Andaj, Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se kërkesa e specifikuar në nenin III.2.3. në njoftimin për kontratë, është në kundërshtim me nenin 69 paragrafi 2 pika 2.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, ku thuhet: Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Agjencia pas trajtimit të dokumentacionit për tenderin me titull: **“Furnizim me IP kamera te jashtme dhe te brendshme”** me nr. të prokurimit 254/18/1265/136, nr. të brendshëm ASHNA/18/016/136, ju njofton me të gjeturat e këtij aktiviteti të prokurimit dhe rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

